



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 14 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Afatit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Huper

Mbrojtësit të viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 9(5)(a) dhe (6) dhe 97(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 24 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) që, deri të premtën, më 23 prill 2021, të dorëzonte përgjigjet ndaj mocioneve paraprake të dorëzuara nga Mbrojtja në përputhje me rregullën 97(1) të Rregullores, dhe Mbrojtjen që të dorëzonte kundërpërgjigjet ndaj përgjigjeve të ZPS-së deri të premtën, më 14 maj 2021.²

2. Më 12 maj 2021, Mbrojtja e Kadri Veselit (“Mbrojtja e Veselit”) dorëzoi një kërkesë për ndryshimin e afatit në mënyrë që të parashtronte kundërpërgjigjen ndaj përgjigjeve të ZPS-së deri të hënën, më 17 maj 2021, në orën 11:00 me orën e Evropës Qendrore (“Kërkesa e Veselit”), me arsyetimin se afatit të 14 majit 2021 i paraprijnë dy pushime zyrtare dhe se gjendja e jashtëzakonshme në shtetin ku banon bashkëmbrojtësi pengon aftësinë e tij për të punuar.³

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

3. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të zgjasë afatet që ka përcaktuar.

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, Transkript, 24 mars 2021, faqja 391, rreshtat 10-17.

³ KSC-BC-2020-06, F00290, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Ndryshim të Afatit*, 12 maj 2021, publike, para. 3, 6.

4. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret edhe pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

III. DISKUTIM

5. Ndonëse Mbrojtja e Veselit ose e ka ditur ose duhej ta dinte se afatit të 14 majit 2021 i paraprinin dy pushime zyrtare, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se janë paraqitur arsye të vlefshme për ndryshimin e kërkuar të afatit bazuar në faktin se gjendja e jashtëzakonshme në shtetin ku banon bashkëmbrojtësi pengon aftësinë e tij për të punuar. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka marrë parasysh edhe faktin se ndryshimi i kërkuar i afatit është i kufizuar dhe se në konsultimet *inter partes*, ZPS-ja ka vënë në dukje se nuk e kundërshton Kërkesën e Veselit “në frymën e mirësjelljes dhe respektit të ndërsjellë”.⁴

IV. VENDIM

6. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** Kërkesën e Veselit; dhe
- b. **URDHËRON** z. Veseli të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij ndaj përgjigjeve të ZPS-së në lidhje me mocionet paraprake të dorëzuara nga Mbrojtja në përputhje me rregullën 97(1) të Rregullores, deri të hënën, më 17 maj 2021, në orën 11:00 me orën e Evropës Qendrore.

⁴ Kërkesa e Veselit, para. 4.

_____nënshkrimi_____

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 14 maj 2021

Në Hagë, Holandë